

Komuna e Shtërpçës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Shtërpçës bashkëqeveriset nga Partia e Pavarur Liberale Serbe (SLS) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Kryetari i Komunës z.Bratislav Nikolić vjen nga radhët e SLS, kurse nënkryetari nga PDK. PDK udhëheq edhe me tri drejtori komunale: Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Drejtorinë e Administratës dhe Drejtorinë e Shëndetësisë.
2. Shumicën e vendeve në Kuvendin Komunal të Shtërpçës i mbajnë partitë shqiptare, ndonëse struktura etnike e popullsisë në këtë komunë është shumicë serbe. Shkakut e refuzimit të një pjese të serbëve lokal për të dalë në zgjedhje ka rezultuar në këtë konfiguracion politik në Kuvendin Komunal. Kësisoj, nga gjithsej 19 ulëse në Kuvendin Komunal, 9 ulëse i ka partija serbe (SLS) dhe 10 ulëse partitë shqiptare (5 PDK, 2 LDK dhe 3 PSK).
3. Nga regjistrimi i fundit i popullsisë, Komuna e Shtërpçës ka 6.949 banorë.¹ Kjo komunë është e njohur për rajonin e Brezovicës, i cili tërheq vizitorë në të gjitha stinët e vitit, veçmas gjatë dimrit, për faktin e ekzistimit të qendrave të përshtatshme të skijimit.
4. Nga hulumtimi i zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore në këtë komunë në atë kohë kanë qenë mungesa e transportit publik, dëmtimi i pasurive natyrore, ndotja e lumit Lepenc, ndërtimet e egra në rajonin e Brezovicës dhe mungesa e parkingjeve për vetura.²

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Shtërpçës. 2009. Fq 3. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/51317_Sht%C3%ABrpca-raporti%20komunal.pdf

Problemet kryesore në Komunën e Shtërpcës 2013

- 1. Derdhja e kanalizimeve në lumin “Lepenc”.** Të gjitha kanalizimet fekale dhe atmosferike në Komunën e Shtërpcës derdhen në lumin Lepenc. Derdhja e këtyre kanalizimeve vlerësohet të ndikojë në ndotjen e rrjedhës së lumit dhe në përhapjen e erës së keqe dhe insekteve. Kjo gjendje është e tillë edhe brenda qytetit të Shtërpcës, si dhe në fshatrat Kashtanjevë, Drekoc, Shushicë dhe Sevc. Ky problem do të mund të evitohet me rregullimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza.
- 2. Mungesa e trotuarit në relacionin Drekoc – Firaj - Brod.** Kjo rrugë vlerësohet si njëra ndër më të përshkuarat nga automjetet. Rruga nuk ka trotuar në asnjërën anë të saj, ndërsa gjatësia e saj është mbi 2 kilometra. Kjo rrugë përshkohet në vazhdimësi nga nxënësit e shkollës së mesme “Kongresi i Manastirit”. Në hulumtimin e zhvilluar nga USAID/DEMI, 28% e qytetarëve në Shtërpcë janë shprehur të pakënaqur me gjendjen e trotuareve në vendbanimet e tyre.³
- 3. Mungesa e urës në fshatin Brod.** Nxënësit e shkollës së quajtur “NR1” kalojnë një përrua të ujit për të arritur në shkollë. Gjatë sezonës së vjeshtës dhe dimrit përroi sjell sasi të konsiderueshme të ujit duke vështirësuar kalimin. Ndërtimi i një ure do të evitonte këtë problem dhe pasojat e mundshme.
- 4. Mungesa e terrenit sportiv në shkollën “Razim Cakli”.** Kjo shkollë nuk ka hapësirë të brendshme për ushtrimin e lëndës së edukatës fizike dhe aktiviteteve sportive. As në pjesën e jashtme nuk e ka të rregulluar terrenin sportiv. Fëmijët shpesh hasen duke luajtur në rrugën e asfaltuar që përshkohet nga automjetet e shumta.
- 5. Mungesa e çerdhes.** Në Shtërpcë ekzistojnë dy çerdhe të cilat procesin edukativo–rekreativ e zhvillojnë vetëm në gjuhën serbe. Kjo ka bërë që vendbanimet e populluara me shqiptarë të mos mund të shfrytëzojnë shërbimin e çerdhes. Për të evituar këtë problem kërkohet ndërtimi i çerdheve në fshatin Brod dhe në fshatin Firaj.

³ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 29. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

6. Ndërtimet në zonën turistike Brezovica. Bashkëbiseduesit në këtë komunë kanë shfaqur shqetësimin e tyre me shkallën gjithnjë e në rritje nga ndërtimet në zonën turistike të Brezovices. Disa prej këtyre ndërtimeve janë bërë pa leje përkatëse komunale, duke dëmtuar hapësirat pyjore të kësaj ane.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur dhe ruajtur


- 1. Rajoni i Brezovicës.** Bashkëbiseduesit nga kjo komunë kanë kërkuar që komuna të parandalojë ndërtimet e egra në këtë zonë dhe po ashtu të parandalojë manipulimin e individëve të caktuar me prona publike e komunale në këtë zonë, faktorë këta që besohet të ndikojnë keq në zhvillimin e kësaj ane.
- 2. Ruajtja e pyjeve.** Bashkëbiseduesit në këtë komunë këtë e kanë konsideruar si dëm të madh që po u bëhet pyjeve dhe kanë kërkuar marrjen e masave në zvogëlimin apo edhe ndërprerjen e tërësishme të kësaj veprimtarie.

Trendet Buxhetore në Komunën e Shtërpcës

Komuna e Shtërpcës në vitin 2013 ka planifikuar 3.3 milion euro buxhet. Viti 2012 ka qenë viti kur kjo komunë ka shënuar buxhetin më të lartë (4 milion euro), ndërsa duke krahasuar buxhetin e vitit 2013 me atë të 2010 shohim se buxheti i kësaj komune ka shënuar rënie prej 486 mijë euro (12%). Të hyrat vetanake në vitin 2012 kanë qenë 231 mijë euro. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm⁴ ka konstatuar se planifikimi për inkasimin e të hyrave ka qenë i dobët në këtë komunë dhe borxhi ndaj komunës arrin në 795 mijë euro. Në vazhdim, është gjetur të mos ketë pasur harmonizim mes departamenteve në barazimin e të hyrave gjë që rritë rrezikun për raportim jo të drejtë të të hyrave.

⁴ ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Shtërpcës Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 03 Shtator 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KSH_2012_Shqip_226333.pdf

Figura 1. Buxheti i Komunës së Shtërpcës- 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?shterpce/2013#/~/~shterpce>

Në bazë të grafikonit mbi ndarjet buxhetore shohim se investimet kapitale kanë pasur një trend të vazhdueshëm të rënies. Nëse krahasojmë shpenzimet kapitale të vitit 2013 me ato të 2010, shohim se Komuna e Shtërpcës shpenzon 1.5 milion euro më pak në këtë kategori. Në vazhdim, në vitin 2010 kjo kategori e shpenzimeve përbënte 68% të buxhetit, ndërsa në vitin 2013 vetëm 29%. Kur jemi tek shpenzimet, Raporti i Auditorit për vitin 2012 ka gjetur raste të tejkalimit të shumave të lejuara për punë shtesë që është në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik. Në vazhdim, në kontratën për furnizim me materiale shëndetësore komuna kishte tejkaluar shumën e kontraktuar për 46

mijë euro. Së fundmi, njëra ndër të gjeturat e auditorit është rritja e madhe e shpenzimeve për dreka dhe mungesa e dëshmimeve për këtë kategori të shpenzimeve.

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014-2016 për komunën e Shtërpcës vlerësohet se krahasuar me vitin 2013, komuna do të ketë rënie të buxhetit në vitet në vazhdim. Kjo rënie do të ndodhë për shkak të uljes së vlerës së granteve. Kjo rënie në të hyra do të ndikojë që të ulen të gjitha kategoritë e shpenzimeve, përveç kategoria e “pagave dhe mëditjeve” e cila do të shënoj rritje.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	2.885.923	2.615.588	2.660.635
Të hyrat vetanake	304.500	313.635	319.908
Grantet	2.581.423	2.301.953	2.340.727
Shpenzimet	2.885.923	2.615.588	2.660.637
Pagat dhe Mëditjet	1.652.894	1.657.394	1.666.549
Mallrat dhe Shërbimet	537.797	455.886	462.308
Shpenzimet Komunale			
Subvencionet dhe Transferet	64.000	24.467	28.178
Shpenzimet Kapitale	631.232	477.841	503.602

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Shtërpcës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruar përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.